

# RELACION

## “PËR

### **PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9632 DATË 30.10.2006 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR.”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Propozimi i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, është mbështetur në nenet: 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ky projektligj është pjesë e Paketës Fiskale 2019.

Projektligji synon disa ndryshime dhe shtesa në ligj, si dhe anekseve që i bashkëlidhen ligjit, me qëllim thjeshtimin e kuptimit të dispozitave për zbatimin e tyre nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ndryshimet ligjore të propozuara për ligjin nr. 9632/2006, të ndryshuar, nuk prekin nivelet ekzistuese të taksave.

Këto ndryshime synojnë të përmirësojnë dispozitat e ligjit, si dhe për të lehtësuar zbatimin e tij.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj është i parashikuar në programin analitik të projekt-akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë 4-mujorit të III-të të vitit 2018.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj janë pjesë e propozimeve të Paketës Fiskale 2019, që nuk sjellin ndryshime të nivelit të taksave, por kanë si qëllim:

a) Harmonizimin në tërësi të ligjit me ndryshimet që vetë ligji ka pësuar deri më tani, si dhe me ligjet e veçanta të miratuara, që janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat vendore”, si dhe ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

b) Lehtësimin e kuptimit dhe interpretimit ligjor të disa dispozitave të veçanta të tij. Ndryshimet dhe shtesat në ligj synojnë që dispozitat e ligjit të bëhen të kuptueshme dhe të zbatueshme.

Projektligji, synon të sqarojë më konkretisht kush janë rastet e përjashtimit nga pagesa e taksës së ndërtesës për ndërtesat e banimit për pensionistë, si dhe për ndërtesat kulturore.

Projektligji parashikon të rregullojë edhe nenin 27 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, duke synuar thjeshtimin e zbatimit të këtij neni.

Gjithashtu, në projektligj propozohet që taksa e tabelës të përcaktohet në një nen të vetëm, nga dy që janë aktualisht, i përkufizuar dhe kategorizuar në harmonizim me aneksin 7, bashkëlidhur ligjit.

Në projektligj propozohet që rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse, apo të shërbimit informatik, u nënshtrohen tarifave vendore në rastin kur subjektet përdorin rrjete infrastrukturore të tilla, si tubacione, kanale etj, që janë ndërtuar dhe që janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, të ardhurat e siguruara nga këto tarifa, do të përdoren për përballimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit në përdorim.

Projektligji parashikon shfuqizimin e anekseve 4, 5 dhe 6, të cilët për shkak të rregullimeve ligjore në ligjin aktual, nuk gjejnë zbatim.

Ndërkohë, anekset 2, 2.1, 3 dhe 8, bashkëlidhur ligjit në fuqi, janë të formatuara sipas ndarjes së vjetër territoriale përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë arsye, tabelat e këtyre anekseve janë rikonceptuar sipas ndarjes së re territoriale. Projektligji parashikon që anekset 2, 2.1, 3 dhe 8 të ligjit aktual, të zëvendësohen përkatësisht me anekset me numurat 1, 2, 3 dhe 8, të rikonceptuara, duke zëvendësuar njëkohësisht numurat e anekseve 2 dhe 2.1, përkatësisht me numurat 1 dhe 2.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është mbështetur në nenet: 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT**

Projektligji nuk prek nivelet e taksave vendore të përcaktuara në ligjin aktual. Ai synon harmonizimet dhe standartizimet e nevojshme ligjore, për t'u përshtatur me ndryshimet që ligji ka pësuar në vite, si dhe ligjit për vetëqeverisjen vendore, ligjit për financat vendore, ligjit për ndarjen territoriale. Më konkretisht, ky projektligj parashikon:

Në nenin 1 të projektligjit, parashikohet ndryshimi në përmbajtje i pikës 5 të nenit 3 “Përkufizime”, për të qenë në harmonizim me ndryshimet që ka pësuar në kohë ky ligj.

Në nenin 2, të projektligjit, parashikohet rregullim termi në nenin 5, për t’iu përshtatur legjislacionit aktual në fuqi.

Në nenin 3, të projektligjit, parashikohet riemërtimi i aneksit 2.1 në “Aneksi 2”.

Në nenin 4, të projektligjit, parashikohen riformulime dhe shtesa në pikën 6 të nenit 22, për të sqaruar rastet e përjashtimit nga taksa e ndërtesës për disa kategori ndërtesash.

Në nenin 5, të projektligjit, parashikohet riformulim i shkronjës “c” të nenit 22/4 të ligjit.

Në nenet 6 dhe 7 të projektligjit, parashikohen riemërimi i aneksit 2 dhe të aneksit 2.1 të përmendura në nenet 23 dhe 23/1 të ligjit, respektivisht në “Aneksi 1” dhe “Aneksi 2”.

Në nenin 8 të projektligjit, parashikohet që në nenin 24 të ligjit, krahas bashkive të shohet dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, si institucion që duhet të marrë të dhëna për ndryshimet në regjistrin e pasurive të paluajtshme nga ZVRPP.

Në nenin 9 të projektligjit, parashikohen rregullime në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 27 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, me qëllim thjeshtimin e zbatimit të nenit.

Në nenin 10 të projektligjit, parashikohet ndryshimi në titull dhe në përmbajtje i nenit 32 “Taksa të tjera”, duke e riemëruar “Taksa e tabelës” me qëllim që kjo taksë të përcaktohet me dispozita në një nen të vetëm dhe shfuqizuar nenin 32/1.

Në nenin 11, të projektligjit, parashikohet shfuqizimi i nenit 32/1 “Taksa e tabelës”.

Në nenin 12, të projektligjit, parashikohet shtim paragrafi në pikën 4 të nenit 35 “Tarifat vendore dhe administrimi i tyre”.

Në nenin 13, të projektligjit, parashikohen riformulime termash në ligj, për t’iu përshtatur legjislacionit aktual në fuqi.

Në nenin 14, të projektligjit, parashikohet shfuqizimi i anekseve 4, 5 dhe 6, bashkëlidhur ligjit.

Në nenin 15, të projektligjit, parashikohet që anekset 2, 2.1, 3 dhe 8, bashkëlidhur ligjit, të zëvendësohen përkatëkatësisht me anekset 1, 2, 3 dhe 8, bashkëlidhur këtij projektligji.

Në nenin 16, të projektligjit, parashikohet hyrja në fuqi e tij.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI**

Për zbatimin e këtij projektligji, ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT**

Ministria e Financave ka draftuar projektligjin. Projektligji i është dërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrin të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me shkresë nr. 17934 dhe 17934/4, datë 08.10.2018. Në vijim të kësaj shkrese, institucionet e sipërcituara kanë shprehur mendimet e tyre, si vijon:

- Ministria e Drejtësisë shprehet dakord me projektligjin e paraqitur për miratim.
- Ministria e Brendshme nuk ka dhënë përgjigje.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shprehet dakord në parim me projektligjin e paraqitur për miratim.

- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në parim shpreh mendimin pozitiv dhe nuk ka paraqitur komente. Ndërkohë, ka përcjellë edhe disa sugjerime nga ana e shoqatave të biznesit lidhur me mënyrën e vendosjes nga bashkitë të taksave të përkohshme dhe të tarifave vendore, të cilat nuk mund të merren parasysh, pasi janë të rregulluara me dispozita të veçanta në ligjin nr. 68/2017 “Për financat vendore”.

## **X. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projektligj nuk paraqet efekte në buxhetin e shtetit dhe buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

**MINISTËR**

**Arben Ahmetaj**